



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.

Prot.

Tiranë ___/___/2022

Nr. Dok. 202201203/2

Lënda: Rekomandim për zbatimin me korrektësi të rasteve dhe kritereve ligjore të shoqërimit, ndalimit/arrestimit të shtetasve në ambientet e organeve të Policisë së Shtetit dhe trajtimin e tyre me dinjitet në përputhje me aktet normative në fuqi.

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

TIRANË

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË

TIRANË

KOMISARIATIT TË POLICISË NR.5

TIRANË

Për dijëni: z. Fatmir Isufi
IEVP Fushë-Krujë

Të nderuar,

Më datë 26.03.2022, në media është bërë publik lajmi, se në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, në rrethana ende të paqarta, ka rënë zjarr në ambientet e dhomave të sigurisë dhe si pasojë ka humbur jetën i paraburgosuri Arben Mici, 26 vjeç, lindur në Kukës, dhe banues në fshatin Çerkezë, Kamëz. Sipas raportimeve të mediave, përveç viktimës ka mbetur i lënduar dhe një tjetër i paraburgosur dhe një punonjës policie. Gjithashtu, raportohet se me ndërhyrjen e zjarrfikëseve dhe të punonjësve të policisë të Komisarariatit nr. 5, zjarri u shua¹.

Me marrjen dijëni të këtij lajmi, Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, ngriti grupin e punës, me qëllim verifikimin e situatës në vend, si dhe sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

¹ <https://abcnews.al/zjarri-ne-komisariat-in-e-kamzes-zjarrfikesja-shkoi-30-minuta-me-vone-flet-i-denuari-qe-shpetoi-nga-qelia-me-nxori-polici/>

Në vijim të inspektimit tematik, u morën takime me drejtuesin e Komisarariatit nr. 5 Kamëz, Tiranë, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit. Po ashtu, drejtuesit e këtij institucioni na informuan në mënyrë kronologjike që nga ardhja në këtë institucion e shtetasit Arben Mici dhe deri në ngjarjen e ndodhur. Në vijim, ai na informoi se një pjesë e dokumentacionit të administruar nga ky komisarariat ishte sekuestruar nga organi i prokurorisë, në kuadër të procedimit penal të regjistruar nga ky organ lidhur me këtë ngjarje.

Pasi morëm informacionin nga shefi i komisarariatit, vijuan veprimet verifikuese duke bërë këqyrjen e dokumentacionit përkatës dhe të ambienteve të sigurimit. Nga ana jonë u administrua një kopje e regjistrit elektronik (sistemi ADAM); fotokopja e faqes së regjistrit të personave të shoqëruar, në të cilin gjenden të pasqyruara të dhënat për shtetasin Arben Mici; fotokopja e librit të vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar në këtë komisarariat dhe kopja e kartelës shëndetësore të shtetasit Arben Mici, ku pasqyrohet se pacienti ka referuar se vuan nga probleme të shëndetit mendor. Në ekzaminimin objektiv thuhet se pacienti është i qetë dhe sugjerohet të vizitohet nga një mjek specialist, si dhe i është dhënë mjekimi i duhur. Gjithashtu, u administrua kopja e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e menjëhershëm të urdhrit të mbrojtjes për paditësen Lirije Mici, me numër 10896, datë 08.03.2022 dhe e shkurtimit të vendimit nr. 715 akti, datë 26.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vlerësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”; kopja e procesverbalit të arrestimit në flagrancë të shtetasit Arben Mici në datën 23.03.2022; kopja e kontrollit personal të tij, ku thuhet se nuk i është gjetur asgjë me vete; karta e të drejtave; certifikatë personale dhe familjare. Me datë 06.05.2022 është administruar ankesa e shtetasit Fatmir Isufi, i cili na bëri me dije në lidhje me ngjarjen e ndodhur në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë, si dhe vendimin e caktimit të masës personale “Arrest me burg” ndaj personit të tij. Gjithashtu, është administruar shkresa nr 2374/1 prot, datë 01.04.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku na bëjnë me dije për “mbylljen e mos funksionimit të dhomave të sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr. 5, në DPV Tiranë”. Në vijim, konstatohet se koha e qëndrimit të këtij shtetasi në komisarariat është brenda afatit 96 orë, dhe se nuk konstatohet kalimi i afateve të qëndrimit në komisarariat.

Nga këqyrja e dokumentacionit vërehet se i arrestuari Arben Mici ishte përsëritës në kryerjen e veprave penale të ndryshme, si: vjedhja, plagosja, prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja e armëve të ftohta, për shitje të lëndëve narkotike, dhunë në familje etj., për të cilat nga viti 2012 e në vijim, ai ishte shoqëruar në këtë komisarariat 22 herë. Për disa nga këto raste ishte bërë referimi i materialeve procedurale në organin e prokurorisë.

Në përfundim të hetimit administrativ të kryer në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, nga administrimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në ambientet e këtij komisarariat, në datën 26.03.2022, konstatohet se:

Në datën 22.03.2022, rreth orës 22.20 është marrë njoftim nga Salla Operative e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë për një konflikt familjar në banesën e shtetasit Ahmet Mici, banues në fshatin Çerkezë, të Bashkisë Kamëz.

Mbi bazën e këtij njoftimi, strukturat e Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz kanë shkuar në banesën e shtetasit Ahmet Mici dhe kanë bërë shoqërimin e djalit të tij, shtetasit Arben Mici.

Në vijim të ndjekjes së këtij konflikti, në orën 23:30 është paraqitur në këtë komisarariat shtetasja Lirije Mici dhe ka bërë kallëzim ndaj djalit të saj, shtetasit Arben Mici. Në këtë kallëzim ajo ka deklaruar se, prej 6 vitesh Arbeni ushtronte dhunë psikologjike duke e shoqëruar me sharje,

ofendime të rënda e kërcënime ndaj saj. Sipas kallëzueses, ka patur edhe raste që, ai ka ushtruar dhunë fizike ndaj saj, duke referuar një rast para dy javësh, kur ajo ndodhej vetëm në banesë dhe Arbeni ka ardhur në gjendje të dehur dhe i ka kërkuar lekë. Pasi ajo i është përgjigjur se nuk kishte lekë, ai e ka fyer rëndë atë me fjalë të ulta, e ka kërcënuar se do ta therte dhe ndërkohë e ka dhunuar fizikisht duke e qëlluar me grushta e shkela në trup dhe në kokë. Për këtë rast, ajo ka deklaruar se kishte shkuar në komisariat, kishte bërë kallëzim dhe ishte pajisur me urdhër mbrojtje, me numër 10896, datë 08.03.2022 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj djalit të saj Arben Mici. Sipas kallëzueses, dhe pasi ajo është pajisur me urdhër mbrojtjeje nga gjykata, Arbeni ka vazhduar ta dhunojë psikologjikisht atë duke e fyer e kërcënuar me jetën.

Ndërsa, në datën 22.03.2022, rreth orës 19:30, Arbeni ka hyrë në banesë dhe me zë të lartë i ka kërkuar asaj lekë. Pasi ajo i ka thënë se nuk kishte lekë që t'i jepte, ai ka tentuar të fikte dritat duke kapur telat e korentit. Pas kësaj ai ka dalë jashtë banesës, është kthyer përsëri dhe ka tentuar të hapte bombulën e gazit, duke kërcënuar se, do t'i digjte të gjithë brenda në shtëpi, se do t'i therte të gjithë dhe ndërkohë ka tentuar ta dhunojë atë fizikisht. Në këtë moment kanë ndërhyrë pjestarët e tjerë të familjes dhe kanë mundur që të ndalojnë veprimet e dhunshme të Arbenit, ndaj nënës së tij. Gjithashtu, në kallëzim ajo ka deklaruar se si pasojë e sjelljes agresive, dhunës psikologjike e fizike të ushtruar nga djali i saj Arbeni, jeta e saj dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes është bërë e padurueshme. Në kohën që ajo është nisur për të shkuar në komisariat për të bërë kallëzim ndaj tij, ka marrë me vete edhe urdhrin e mbrojtjes, por Arbeni ia ka marrë atë nga duart dhe e ka grisur, duke vazhduar me fyerjet dhe kërcënimet ndaj saj.

Në bazë të këtij kallëzimi të bërë nga shtetasja Lirije Mici dhe duke vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të shtetasit Arben Mici, nga strukturat e Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit Arben Mici, për veprat penale “Dhunë në familje” dhe “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”. Pas përfundimit të procedurave të arrestimit dhe të kontrollit personal, shtetasi Arben Mici është akomoduar në ambientet e dhomave të ndalim/arrestimit të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz.

Në datë 26.03.2022, ora 09:00, i arrestuari Arben Mici, së bashku me të arrestuarin tjetër, shtetasin Dilaver Idrizi, janë marrë nga togat e shoqërimit e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe janë dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vlerësimin dhe caktimin e masës së sigurisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin me nr. 715, datë 26.03.2022 ka vendosur si të ligjshëm vleftësimin e arrestit në flagrancë të personit nën hetim Arben Mici dhe caktimin si masë sigurimi personal “Arrest me burg” ndaj tij.

Pasi është dhënë vendimi, po në këtë datë, rreth orës 13:00, i arrestuari Arben Mici dhe personi tjetër i arrestuar janë shoqëruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz nga togat e shoqërimit të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Sipas shefit të komisarariatit, nga punonjësit e policisë të cilët kanë qenë me shërbim, në ambientet e sigurisë është bërë kontrolli fizik i të arrestuarit Arben Mici, por nuk janë konstatuar sende të kundraligjshme dhe më pas ai është akomoduar në dhomën e sigurisë nr.1 të këtij ambienti në Komisariatin e Policisë nr. 5 Kamëz, Tiranë. Në vijim, nga ana e personit përgjegjës të institucionit janë bërë shënimet përkatëse për të paraburgosurin e vendosur në dhomën e arrestimit/ndalimit të komisarariatit. Sqarojmë se, ne nuk mundëm të pyesnim vetë punonjësit e policisë, që kanë qenë me shërbim në këtë datë në ambientin e sigurisë, sepse ata janë të arrestuar për ngjarjen në fjalë.

Në datën 26.03.2022, rreth orës 20:50, punonjësi i policisë, inspektor Hajredin Boja, ka njoftuar ndihmës oficerin e informacionit, z. Mark Mirashi, se në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr. 5, Kamëz, kishte rënë zjarr në rrethana të paqarta. Menjëherë shërbimet e policisë të këtij komisaritati, kanë nxjerrë nga dhoma e sigurisë të arrestuarin Dilaver Idrizi dhe dy të shoqëruar të tjerë të cilët ndodheshin në dhomën e shoqërimit, që gjendet pranë ambientit të sigurisë. Më pas, punonjësi i dhomave të sigurisë, inspektor Hajredin Boja ka hyrë përsëri në dhomat e ndalim/arrestimit, me qëllim për të evakuuar të arrestuarin Arben Mici.

Në vijim të veprimeve nga ana e shërbimeve të policisë është hapur hidranti i ujit dhe menjëherë ata kanë zbritur në katin e parë të godinës me qëllim për të fikur zjarrin në këtë ambient.

Punonjës të policisë kanë hyrë në ambientet e dhomave të sigurisë dhe kanë nxjerrë punonjës in e policisë, inspektor Hajredin Boja, i cili ishte i djegur dhe është transportuar në katin e parë të godinës e më vonë në spital.

Pas pak minutash, në këtë komisarariat kanë ardhur edhe disa automjete zjarrfikëse. Punonjësit e këtij shërbimi kanë hyrë për të kontrolluar të gjitha dhomat e sigurisë dhe kanë njoftuar se kishin gjetur një person në tualetin e dhomave të sigurisë. Personi i gjetur në këtë ambient ishte shtetasi Arben Mici, të cilit i është dhënë ndihma e parë dhe i është vënë oksigjen nga ekipi i urgjencës, duke e transportuar me automjetin e urgjencës në spital, ku më pas ka ndërruar jetë. Pas kontrollit të ushtruar në rrobat e të ndjerit, Arben Mici janë gjetur një çakmak dhe një paketë cigare.

Ndërkohë, nga ana e zjarrfikësve është vijuar për fikjen e zjarrit, ndërsa personat e tjerë të shoqëruar dhe i arrestuari, u transferuan në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Nga shefi i komisarariatit u informuam se në datë 26.03.2022, në ambientet e sigurisë e të shoqërimit të këtij komisaritati kanë qenë gjithsej 4 persona, nga këta dy të arrestuar dhe të akomoduar në dhomat e ndalim/arrestimit dhe dy të shoqëruar dhe të akomoduar në dhomën e shoqërimit. Për ngjarjen e ndodhur, zjarrin e rënë, nga strukturat e Komisarariatit të Policisë nr. 5 Kamëz janë njoftuar strukturat eprore, si dhe drejtuesi i prokurorisë. Aktualisht çështja është nën hetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Agjencia për Mbikëqyrjen Policore. Në kuadër të këtij procedimi penal është sekuestruar dokumentacioni që lidhet me ngjarjen e ndodhur në këtë komisarariat.

Nga drejtuesit e këtij komisaritati është bërë një analizë në lidhje me ngjarjen e ndodhur. Sipas informacionit verbal të dhënë nga shefi i komisarariatit, pas analizës së bërë është konstatuar se, në dhomën ku ishte akomoduar i arrestuari Arben Mici është dhënë së pari shkëndija e zjarrit.

Nga kqyrja e bërë në këtë dhomë u konstatua se aty ndodhej një krevat metalik, mbi të cilin vëreheshin mbetje sfungjeri dhe të batanijeve të djegura nga zjarri, si dhe në anën e djathtë, përballë krevatit, dallohej një grumbull materiali prej sfungjeri e rrobash të djegura, grumbull i cili mendohej të jetë dhe vatra fillestare e zjarrit.

Gjithashtu u konstatua djegia sipërfaqësore e dyshekut dhe batanijes në një masë gati 80%, duke mos u djegur e gjitha si pasojë e ndërhyrjes së forcave zjarrfikëse, fakt i cili na bën të mendojmë se zjarri ka filluar në dysheme, tek grumbulli i sfungjerit dhe batanijeve që

ndodheshin aty. Ndërkohë, konstatoam se nga temperatura e lartë ishte djegur edhe polisteroli, që ndodhej në strukturën e tavanit (soletën) të kësaj dhome.

Për ngjarjen e ndodhur dhe shkeljet e konstatuara, nga drejtuesit e këtij komisariati ka nisur ecuria disiplinore për disa punonjës për shkelje të rënda të disiplinës sipas ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, neni 95 thuhet se shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të policisë, që bie në kundërshtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Policisë.² Konkretisht, ka filluar masa disiplinore për disa punonjës të policisë për shkelje të rënda të disiplinës për inspektor Hajredin Boja, me detyrë trup shoqërimi në dhomat e ndalim/arrestimit, inspektor Fatmir Isufi, me detyrë oficer i Patrullës së Përgjithshme, inspektor Mark Marashi, me detyrë përgjegjës i dhomave të ndalim/arrestimit, komisar Ylli Çollaku, me detyrë shef i Patrullës së Përgjithshme, inspektor Sali Elezi, me detyrë trup shoqërimi në dhoma ndalim/arrestimi, si dhe inspektorët Shkëlqim Dyrmishi, me detyrë trup shoqërimi në dhoma ndalim/arrestimi, inspektor Mehmet Daka me detyrë trup shoqërimi në dhoma ndalim/arrestimi, si dhe inspektor Petrit Nika, me detyrë ndihmës specialist informacioni. Gjithashtu, inspektor Hajredin Boja dhe inspektor Fatmir Isufi janë të arrestuar nga prokuroria për veprën penale “Shpërdorim detyre” në lidhje me ngjarjen e ndodhur në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.5 Kamëz, Tiranë.

Nga inspektimi i ambienteve të sigurisë të këtij komisariati u konstatua, se në këtë komisariat ka 3 dhoma sigurie me sipërfaqe 2 x 3m, ku dritaret e dhomave janë të vogla dhe nuk mundësojnë futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe të dritës natyrale.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit shkaqet e ndodhjes së kësaj ngjarjeje janë:

Mosfunksionimi korrekt i strukturave të Komisarariatit nr. 5 Kamëz, që kanë për detyrë ruajtjen dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar dhe neglizhenca e tyre për ushtrimin e detyrës në zbatim të akteve normative në fuqi, të cilat rregullojnë shërbimin e ruajtjes, sigurimit dhe trajtimit të personave të arrestuar/ndaluar në këtë institucion. Futja apo lejimi i çakmakut në ambientet e sigurisë, ka sjellë si pasojë aktin e rëndë të kryer nga i arrestuari Arben Mici, vënien e zjarrit në dhomën e tij të sigurisë dhe si rrjedhojë asfiksimin dhe vdekjen e tij, si dhe rrezikimin e jetës dhe të shëndetit të personave të tjerë që ndodheshin aty, duke përfshirë edhe vetë punonjësit e policisë të cilët ishin me shërbim.

Lejimi i futjes së çakmakut dhe i duhanit në ambientin e sigurisë, vjen në kundërshtim me procedurën standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019. Konkretisht me, kapitullin V, pika 9/9.2 parashikon se: *“Para se personi i arrestuar/ndaluar të vendoset në dhomën e sigurisë, kjo e fundit kontrollohet nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë për të verifikuar ekzistencën e kushteve lidhur me: f) Mos ekzistencën e asnjë sendi tjetër (përveç atyre të përcaktuara në këtë procedurë) me të cilin i arrestuari/ndaluari mund të cenojë sigurinë, jetën, shëndetin e tij apo të personave të tjerë (çakmakë, shkrepse, drogë, armë) etj”*.

² Nenin 96 pika 1 të “Ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, thuhet se: Punonjësi i policisë që kryen shkelje disiplinore ndëshkohet disiplinarisht: Për shkelje të lehta disiplinore me masat: vërejtje; vërejtje me paralajmërim, për shkelje të rënda disiplinore me masat, shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet, ulje me një gradë për një periudhë deri në 6 muaj, përjashtim nga policia.

Kapitulli VI, pika 3/2.7 ku parashikohet se: “Të mos mbajë me vete në dhomë sende e mjete të tjera të ndaluar që përbëjnë rrezik për kushtet e sigurisë, për jetën e shëndetin e të ndaluarve e arrestuarve e personelin policor, me përjashtim të atyre të lejuara sipas kësaj procedure.”

Pikën 3/2.8 ku parashikohet: “Të mos konsumojë produkte të duhanit në ambientet/mjediset e mbyllura të sistemit të dhomave të sigurisë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të Ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar”.

Mosrespektimi i procedurës standarde, ku në kreun V pika 2.2.3 thuhet se: “Punonjësit e policisë para se të kryejnë kontrollin e personit duhet të:

- a) “Vlerësojnë situatën e rrezikut gjatë kontrollit.
- b) Tregojnë kujdes për të dalluar çdo veprim, sjellje, qëndrim apo çdo gjë tjetër që tregon se personi vuan nga ndonjë sëmundje mendore, apo gjendje e veçantë shëndetësore”.

Nga këqyrja e kartelës shëndetësore, i arrestuari Arben Mici, ka referuar se vuante nga probleme të shëndetit mendor. Nga ana e përgjegjësit të turnit të dhomave të sigurisë nuk është parë e nevojshme koordinimi dhe vazhdimësia e kujdesit ndaj personit të arrestuar që ka referuar probleme të shëndetit mendor, për sigurimin e një kujdesi sa më të mirë, në mënyrë që shërbimi shëndetësor i të gjitha niveleve të funksionojë në mënyrë të koordinuar, me qëllim mbulimin e nevojave shëndetësore, psikologjike dhe sociale.

Nga punonjësit e policisë nuk janë zbatuar detyrat e parashikuara në Kreun XIV, pika 3 “Detyrat e punonjësit të shërbimit të brendshëm” ku në pikën 3.3 parashikohet: “*Punonjësi i shërbimit të brendshëm duhet të mbajë në mbikëqyrje të arrestuarit/ndaluarit, qëndrimet, veprimet apo tentativat që mund të bëjnë për tu larguar me forcë apo për tu vetë dëmtuar duke i kontrolluar ata çdo 5 minuta.*”

Ndërsa në pikën 3/3.4 parashikohet se: “*Për të arrestuarit/ndaluarit që janë të dehur, përdorues të drogave dhe me çrregullime/dobësi mendore ti kontrollojë jo më pak se një herë në 3 minuta.*”

Dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr. 5 Tiranë nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në procedurën standarde të cituar më sipër, si lidhur me kubaturën, pasi sipërfaqja e dhomave të sigurisë nuk ishte sipas standardeve 10 m², të ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m², si dhe lidhur me ndriçimin e ajrimit natyror të nevojshëm. Nëse dhoma ku është ndezur zjarri do të ishte me kubaturë e dritare më të madhe, ajo pas ndezjes së zjarrit mund të ishte ajrosur dhe mund shmangej rreziku i personave nga asfiksia.

- Ndonëse nga institucioni ynë janë bërë një sërë rekomandimesh ndër vite³ për ndërtimin e dhomave të reja të sigurisë dhe vendosjen në punë të sistemit të monitorimit të tyre konform me procedurën standarde, jo vetëm që rekomandimi nuk është zbatuar, por nuk na është kthyer as edhe përgjigje nga ana e këtij institucioni.

³ Dërguar rekomandimi për inspektimin e bërë në Komisarariatin e Policisë Kamez, K4/I 14-2 prot, datë 16.06.2021.

Është rasti të theksojmë se lidhur me plotësimin e standardeve të ambienteve të sigurisë dhe respektimin e të drejtave të arrestuarve/ndaluarve, rekomandimet e CPT-së dhe të Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato iu drejtohen. Këto rekomandime nuk iu drejtohen personave të caktuar personalisht, por institucioneve të administratës publike dhe drejtuesve të tyre me cilësinë e titullarit. Ne vlerësojmë se nuk është qëndrim aspak serioz, mosreflektimi apo mbajtja e një qëndrimi zyrtar ndaj rekomandimeve të bëra nga bëra nga Avokati i Popullit dhe më parë nga CPT, pavarësisht ndryshimit të vazhdueshëm të titullarëve të institucioneve, Komisarariatet e Policisë Tiranë, kanë detyrimin ligjor në zbatim neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, të mbajnë qëndrimet e tyre ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Institucionet kanë përgjegjësi për të siguruar jetën e personave edhe nëse ato vuajnë nga probleme të shëndetit mendor. Mungesa e vizitës nga mjeku psikiatër është mangësi që parashikohet në procedurave standarde për detyrimin e punonjësve të komisariateve të mos fusin të ndaluar/arrestuar nëse dhomat nuk plotësojnë kushtet sipas kreut VIII të pikes 2 dhe 3 në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Sipas informacionit të marrë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë në muajin tetor 2022, është bërë funksional blloku i dhomave të sigurisë për persona të ndaluar/arrestuar. Avokati i Popullit kërkon përmbushjen e normave dhe standardeve për qëndrimin dhe trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar, për të bërë të mundur garantimin e lirive dhe të drejtave ligjore, sipas përcaktimeve të bëra në konventat ndërkombëtare, Kushtetutë, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit të tij kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63 të pikës 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*.”

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëherëshme për mospërdorimin e dhomave ekzistuese të sigurisë në Komisariatin e Policisë nr. 5, Kamëz, pasi ato nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret që të garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të personave të ndaluar/arrestuar, sipas përcaktimeve në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, si dhe zbatimit të rekomandimit të Komitetit European për Parandalimin e Torturës (CPT).
2. Marrjen e masave të nevojshme organizative nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për mbylljen e të gjitha atyre dhomave e ambienteve të sigurisë në strukturat

vendore të Policisë së Shtetit, që nuk plotësojnë kushtet minimale të standardeve të përcaktuara në procedurën standarde.

3. Përgjithësimin e këtij rasti në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për trajtimin e punonjësve të policisë që kryejnë shërbim në ambientet e sigurimit për zbatimin e rregullave të parashikuara në procedurën standarde për ruajtjen e trajtimin e kësaj kategorie personash.
4. Analizimin e rastit të mos marrjes së masave nga Komisariati i Policisë nr. 5 Kamëz dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për mos zbatimin rekomandimit të Avokatit të Popullit, bërë më shkresën e datës 16.06.2021 dhe mos kthimin e përgjigjes për qëndrimin e mbajtur ndaj tij.
5. Nisur edhe nga disa konstatime të bëra nga ana jonë, kohët e fundit në Komisaritet e Policisë Tiranë, por jo vetëm, të arrestuarit e të ndaluarit vazhdojnë të qëndrojnë për disa ditë edhe pas caktimit të masave të sigurimit “Arrest në burg” nga gjykata, rekomandojmë marrjen e masave organizative dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për transferimin e të arrestuarve/ndaluarve sa më shpejt nga ambientet e Policisë në IEVP konform me marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet këtyre institucioneve, respektivisht me marrëveshjen nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 “Për transferimin në IEVP të të arrestuarve/ndaluarve me masën e sigurisë “Arrest në burg” dhe të dënuarve me “Burgim në mungesë”.
6. Kërkesë rigorozë llogarie për zbatim të procedurave në rastet e pranimit të personave në dhomat e sigurisë.
7. Marrjen e masave për zbatimin efektiv të garancive ligjore të qytetarëve në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre në ambientet policore.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni, brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI